



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2024:109139
Datë: 24.06.2024
Numri i dokumentit: 05850315

K.Dh.Sh.II.nr.684/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Departamenti i Përgjithshëm, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtaren Franciska Zhitija Ymeri në çështjen përmbarimore të kreditorit “Patroni” SH.P.K., me NUI: 811254797, me seli në Miradi e Ulët, Fushë Kosovë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson N.S., avokat në Prishtinë, kundër debitorit “NB Company” SH.P.K., me NUI: 810727563, me seli në Llazarevë, Komuna e Obiliqit, me bazë juridike përmbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e të autorizuarit të kreditorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1360/23 të datës 27.10.2023, me datë 24.06.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e kreditorit “Patroni” SH.P.K., me seli në Miradi e Ulët, Fushë Kosovë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1360/23 të datës 27.10.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale të Kosovës, Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1360/23 të datës 27.10.202, në pikën I të dispozitivit e ka pranuar në tërësi si të bazuar prapësimin e debitorit “NB Company” SH.P.K., me seli në Llazarevë, Komuna e Obiliqit të ushtruar kundër Urdhrit për Përmbarim P.nr. 164/23, të dt. 23.06.2023, të

Përmbaresit Privat Mubarak S. Shumolli dhe i njëjti Urdhër për përmbarim në pikën II të dispozitivit është Shfuqizuar.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë i autorizuari i kreditorit, për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore dhe përmbarimore, për shkak të kontstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjës faktike is dhe për shak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim, të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të ndryshohet aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës Dhoma e Shkallës së Parë - Departamenti Ekonomik, KPPP.nr. 1360/23 të datës 27.10.2023,apo të anulohet dhe lënda të kthehet në rivendosje.

Debitori nuk ka ushtruar përgjigje në ankesë

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e të autorizuarit të kreditorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori “Patroni” SH.P.K., me datën 23.06.2023, ka paraqitur propozimin për përmbarim mbi bazën e dokumentit të besueshëm, dokumentit të besueshëm – Faturës Nr. 155/21 të datës 23.06.2021; me të cilin e ka urdhëruar debitorin që sipas faturës së lartcekur t’ia paguaj kreditorit shumën prej 2,600.00 €, me kamatë ligjore prej 8% nga data e kalimit të afatit për pagesë e deri në pagesën definitive, ashtu që realizimi të bëhet përmes bllokimit të llogarive bankare, regjistrimit, sekuestrimit dhe shitjes të sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit dhe me shitjen e tyre të bëhet inkasimi i borxhit në llogari të kreditorit. Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, ka theksuar ndër të tjerash se urdhri përmbarimor është i papërshtatshëm për ekzekutim, i njëjti është nxjerr në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi. Tutje ka shtuar se debitori nuk ka përgjegjësi për këtë borxh të pretenduar, pasi që debitori faturat i ka paguar rregullisht, ndërsa borxhi i faturuar nuk përputhet aspak me shërbimet e bëra, borxhi është i rritur dhe si i tillë nuk pranohet nga debitori. Po ashtu ka deklaruar se borxhi i kërkuar është parashkruar, pasi që kanë kaluar më shumë se një vit nga koha e lëshimit të faturës. Gjykatës i ka propozuar që të anulohet urdhri përmbarimor, si dhe të

abrogohen të gjitha veprimet përmbarimore të ndërmarra lidhur me propozimin për përmbarim. Kreditori, në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor përmes përfaqësuesit të autorizuar ka kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit në prapësim, duke theksuar ndër të tjerash se pretendimet e debitorit janë të pa qëndrueshme, të pa bazuara dhe pa asnjë mbështetje ligjore. Gjykatës i ka propozuar që prapësimin e debitorit ta refuzojë si të pa bazuar, ndërsa urdhri përmbarimor të mbetet në fuqi.

Gjykata e shkallës së parë pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes së kreditorit në prapësim, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (në vijim: “LPP”) gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbarimor duhet të shfuqizohet, me arsyetim se në rastin konkret Fatura Nr. 155/21 e datës 23.06.2021, në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbarim, nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 të LPP-së. Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se “Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”, ndërsa me nën-par.1.3 të këtij neni fatura përcaktohet si një nga dokumentet e besueshme, kurse me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se “Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit. Duke vlerësuar se faturat Nr. 155/21 e datës 23.06.2021, në bazë të së cilës është mbështetur propozimi për përmbarim dhe është lejuar urdhri përmbarimor është bashkëngjitur në kopje, ndërsa në shkresat e lëndës nuk është deponuar origjinali apo kopja e vërtetuar siç kërkohet me nenin 37 të LPP-së. Në këtë drejtim, rezulton se propozimi për përmbarim mbi bazën e të cilit është lejuar urdhri, përmbarimor të meta ngase në propozim nuk janë treguar dokumentet origjinale apo kopja e vërtetuar mbi bazën e të cilëve është iniciuar procedura përmbarimore, ashtu siç përcaktohet me dispozitën nga neni 38 paragrafi 1 i LPP-së: i cili përcakton se “Propozimi për përmbarim duhet ta përmbajë kërkesën për përmbarim në të cilën do të tregohet dokumenti përmbarimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm”.

Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata Komerciale dhoma e shkallës së dytë, duke vlerësuar po ashtu se

aktvendimi i ankimuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata Komerciale, Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se në rastin konkret kemi të bëjmë me propozim për përmbarim, në bazë të dokumentit të besueshëm-faturës ku me dispozitën e nenit 29 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore nr.04/L-139, përcaktohet se përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet në bazë të dokumentit të besueshëm dhe se dokument i besueshëm sipas LPP-së është: Fatura. Dokumenti i besueshëm, është i përshtatshëm për përmbarim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përbushjes së detyrimit monetar, e në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me dokumentet të besueshme, e që në rastin konkret Fatura Nr. 155/21 e datës 23.06.2021, në bazë të së cilës është mbështetur propozimi për përmbarim dhe është lejuar urdhri përmbarimor është bashkëngjitur në kopje, ndërsa në shkresat e lëndës nuk është deponuar origjinali apo kopja e vërtetuar siç kërkohet me nenin 37 të LPP-së.

Andaj, Gjykata Komerciale, Dhoma e Shkallës së Dytë pas analizimit të shkresave të lëndës vërejtë se në rastin konkret urdhri mbi lejimin e përmbarimit P.nr.164/23 i datës 23.06.2023, është nxjerrë pa u plotësuar kushtet për lejimin e tij, ngase propozimit për përmbarim nuk i është bashkëngjitur origjinali apo kopja e vërtetuar e dokumentit të besueshëm dhe rrjedhimisht propozimi për përmbarim përmban të meta në kuptim të nenit 38 paragrafi 1 të LPP-së,

Po ashtu, kjo gjykate vlerëson pretendimet ankimore por ishin pa ndikim në vendosje ndryshe në këtë çështje përmbarimore. Andaj, nga të cekurat kjo gjykatë vlerësoj se aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë duhet vërtetuar dhe të refuzohet ankesa e kreditorit si e pathemeltë.

\

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika b), të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e shkallës së dytë

K.Dh.Sh.II.nr.684/24, me datë 24.06.2024

Gjyqtarja,
Franciska Zhitija Ymeri